



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.366, Datë 13.11.2023

PËR

“MIRATIMIN E VEPRIMTARISË JASHTË FUNKSIONIT PËR
PROKURORIN MARINGLEN META”

Bazuar në nenet 143, 149/a, *germa “e”*, 149/ç, të Kushtetutës të Republikës të Shqipërisë, nenin 9 të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenin 164, pika 8, nenin 189, pika 1, *germa “a”* të ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, nenin 8 të Rregullores “Për veprimtaritë jashtë funksionit të prokurorëve”, si dhe pasi u njoh me relacionin e përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, i Administrimit dhe Buxhetit, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Miratimin e veprimtarisë jashtë funksionit për prokurorin Maringlen Meta, si lektor i jashtëm për lëndën “E drejta penale”, *Pjesa e Posaçme*, në Fakultetin e Shkencave Politike dhe Juridike, *Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës*, për 30 (tridhjetë) orë gjatë vitit akademik 2023 – 2024.
2. Të njoftohen për këtë vendim zoti Maringlen Meta, Prokurori i Përgjithshëm dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.
4. U shpall në Tiranë, sot më 13.11.2023.

ZV/KRYETAR

Tartar Bazaj

